



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E KAMENICËS
OPŠTINE KAMENICA / MUNICIPALITY OF KAMENICA



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOS.
QENDRA PËR SHËRBIM TE QY
CENTAR ZA USLUGU GRADANA

Sh. 01 Nr. 22382
U. Br.

Nr. i faq. 4 Data: 12/07
Br. str. Datum:
KAMENICË/A 2024

Procesverbali i mbajtjes së dëgjimit buxhetor në fshatin Ajnoc

Dëgjimi me qytetarë është organizuar nga Komisioni për organizimin e dëgjimeve buxhetore në bashkëpunim me Zyrën e Kryetarit dhe Kuvendin Komunal.

Njoftimet për qytetarë për organizimin dëgjimit buxhetor janë bërë në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Publikimet janë bërë në Eëbfaqe, në Facebook dhe në Platformën e Konsultimeve Publike.

Publikimet:

ËBFAQE:

FACEBOOK:

<https://ëëë.facebook.com/photo/?fbid=883651987130468&set=pcb.883652050463795>

<https://ëëë.facebook.com/photo?fbid=883652000463800&set=pcb.883652050463795>

PLATFORMA E KONSULTIMEVE PUBLIKE:

Me **04.07.2024** dëgjimi publik është mbajtur në fshatin Ajnoc duke filluar nga ora **19:10**.

Pjesëmarrës në këtë dëgjim ishin: Shefi i Kabinetit të Kryetarit, Vaxhid Regjepaj, Drejtoresha e Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, Ardita Dërmaku, Nënkryetarja për Komunitete, Aleksandra Jovanovic, Zyrtari Kryesor Financiar, Naser Hashani, zyrtarë të tjerë komunal përgjegjës për mbajtjen e dëgjimeve buxhetore, banorë të fshatit Ajnoc.

Drejtoresha për Buxhet dhe Financa, Ardita Dërmaku ka hapur këtë takim dhe ka prezantuar buxhetin për vitin 2025: Faleminderit që keni ndarë kohën që të jeni pjesë e këtij takimi. Arsyeja kryesore e këtij takimi është që përmes juve t'i marrim projektet prioritare që mendoni se janë të

rëndësishme për juve si OJQ dhe ato më me prioritet t'i vendosim në listën e projekteve për vitin 2025. Buxheti komunal i planifikuar për vitin 2025 do të jetë 15,282,684.00euro ku do të ketë një rritje prej 5.10%, krashuar me vitin 2024, ku pjesa e dedikuar për investimeve kapitale arrin shumë 2.6 milion, ndërsa pjesa për subvencione arrin shumë 885,000.00 euro. Nga ju pres një kontribut të madhë ku gjatë këtij takimi pres që përmes prioriteteve të juaja ti paraqitni në ato kërkesa që ju i konsideroni më të rëndësishmë për fshatin Ajnoc.

Më pasë Nënkryetarja për Komunitete, Aleksandra Jovanovic, ka hapur këtë takim: Faleminderit që keni ardhur këtu. Prezenca juaj do të na ndihmojë për cështjen e buxhetit për vitin 2024. Qëllimi ynë është që në mënyrë efikase ta përdorim dhe shfrytëzojmë buxhetin. Nëse keni kërkesa, propozime, ide lirisht mund të lajmëroheni.

Më pasë Shefi i Kabinitetit të Kryetarit, Vaxhid Regjepaj, ka prezantuar punët të cilat janë kryer në fshatin Ajnoc: Faleminderit që keni gjetë kohë dhe keni ardhë në këtë takim, që të diskutojmë për projekt buxhetin për vitin 2025, ju ftoj kërkoj nga ju që të bëni kërkesa dhe me as sa komuna ka mundësi buxhetori të bëjmë zgjidhje, siq e dini ura për këmbësor vetëm se është duke u përfunduar, ndërsa ura kryesore që lidh kamenicën me fshtarat tjera shumë shpejt do të dal në procedurë të prokurimit dhe të fillojnë punimet, ne si komun kemi nda edhe subvencionat, si dhe ndihmat momentale, ajo qka komuniteti juaj ka nevojë, gjithashtu është ndarë edhe një bursë për një nxënës nga Ajnoci, ka përfitues edhe në subvencionet bujqësore, ne po ashtu kemi me hapur thirrjen për komunitetin serb në sektorin e bujqësis në mekanizma bujqësor. Unë e di që kërkesat janë të mdhaja dhe të nevojshme, por sot bashkarisht do të vendosim se qka do të investojmë në vitin 2025, në fshatin Ajnoc. Ju ftoj të bëni kërkesa dhe të thoni se qka është e nevojshme dhe prioritare për juve.

Kërkesat e banorëve ishin të ndryshme si:

Banori Srdjan Mladenović: Në rrjetin që e kemi për ujësjellës të fshtit, janë rrëmi pusët mirëpo nuk ka pas ujë të mjaftueshme, nëse është e mundur të përsëritet për një pus të ri nëse që të provohet mos po del uji, rrjeti është i vendosur, bazeni është i rregulluar mirëpo aty nuk ka ujë.

Banori Goran Djordjević: Kemi problem në lagjen Jovan Durdjić kemi nevojë për 4 deri në 5 gypa të betonit, sepse qdo shi ose vërshim që bëhet e vërshon rrugën.

Banori Boban Tasić: Unë dua të nderlidhmen më rrëfimin e Sergjanit rreth ujësjellësit, unë nuk e di vetëm nëse ky projekt a egziston në komunë apo jo, kohë më parë edhe është investuar nga Ministria për Kthim dhe Komuniteteve, investitori potencial ka bërë shpuarjet, mirëpo ne nuk e di se sa jemi të angazhuar në këtë projekt, ose të bëhet shpuarja vetëm përreth lumit që të grumbullohet uji në mënyrë natyrale, nëse jo atëher për pije të jetë uji industrial apo teknik, ky është një ndër projektet shumë serioz dhe që ka mbetur në gjysmë, për neve është një projekt jashtzakonisht me rëndësi për lehtësimin e jetesës. Projekti është punuar mirëpo ne na intereson

se në qfarë faze ka mbërri projekti, në qfarë faze ka arrit ky projekt? A mund të vazhdohet me këte projekt apo jo?

Vaxhid Regjepaj përgjigjet: neser do të angjzhona me pa se ku është ky projekt dhe qka është bërë më fatin e tijë, nësë egziton ky projekt në komunë e kemi më të lehtë me kshyr se në qfar faze ka arritur ky projekt.

Banori Radovan Antiç: Mua më intereson për qfarë arsye nuk është prezent asnje nga shqiptarët të fshatit Meshin? Kryetari i bashkësis lokale nuk është ardhë, ku është? Me ndërtimin e kësaj ure jep një shej për mulietnicitetin që unë e perkrahi, po ndëgjoj edhe që asflati po shtrohet deri te kisha, që është edhe një nga prioritetet tona, gjithashtu perkrahi edhe propozimin për pusetat e ujit. Disa projekte në të vërtet janë qe një kohë të gjatë dhe për atë nuk janë përfunduar. Gjithashtu edhe propozimi për gypat e betonit, sepse mundë të jetë nga një shi i madhë vërshimi i ati prroi. A ekziston projekt për këtë uren apo rrugen regjionale?

Shefi i Kabinetit, Vaxhidi përgjigjet: ne komunikim për ajnoc e kemi direkt me juve, dhe qka do që keni qoftë kanalizimi, ujësjellësi, asfaltimi i rrugëve, ejani dhe na tregoni ne. Ura, po është projekti, dhe këta mujtë e verës do të fillojn procedurat e prokurimit në Qeveri. Për gypat e betonit është një projekt dhe qka duhet të bëni është të bëni një kërkes përmes Nënkryetares dhe në vjesht kryhet projekti.

Banori Boban: pasi që i ceket projektet për subvencionet, në 25 vjet e fundit nuk e di a keni në bazen e shënimeve kush ka fituar nga kosova apo nga serbia, mirëpo ta merni parasysh dhe të keni kujdesë që dikush të perfitoj pesë herë dhe dikush asnjeher, dhe nuk e di sa është bashkpunimi i mirefillt ndërmjet komunes dhe daliborit, nuk do të ishte mirë që të bëhet një ndarje ndërjmet banorve në subvencione. Ne fshataret e Ajocit do të ishte mirë të mbajmë një takim dhe ti japim kërkesat dhe porozimet tona që janë më prijoritare për këtë vit apo në vitin e ardhshem. Dhe të kemi parasysh se a mund të kaloj një projekt këtë vitë apo në vitin e ardhshëm.

Shefi i Kabinetit, Vaxhidi përgjigjet: një plotësim, gjatë këtyre viteve në qeversije ne e kemi parë që banorët e komunitetit serb e kan problem që ti plotësojn kriteret të cilat janë të vendosura nga komuna, dhe ajo qka kemi bërë është që ne kemi vendos që do të ketë thirrje vetëm për komunitetit serb, e dyta bashkë me nënkryetaren, janë marë kërkesat nga banorët e komuniteti serb se për qfar kanë nevoj tju ndihmohet me subvencione në bujqësi. Dhe si kriter do të vendoset se ata që kanë përfitur mekanizëm në tri vitet e fundit, nuk mund të përfitojnë përsëri.

Banori Millorad Gigiç: Sa i përket kur folët për subvencionet për makinat bujqësore, une nuk jam i njoftuar aq sa duhet, në qfar adrese duhet të drejtohem i dhe në qfar periudhe kohore duhet të bëhet kërkesa.

	Propozuesi	Propozimi	Formë e Kontaktit
1.	Srdjan Mladenoviç	Hapja e pusetave të ujit,	Me telefon
2.	Goran Djordjeviç	4-5 gypa të betonit, ujra atmosferik	Me telefon


3.	Boban Tasić	Hapja e pusetave të ujit, Subvencione në mekanizëm bujqësor.	Me telefon
----	-------------	--	------------

Të gjitha këto kërkesa të banorëve janë evidentuar nga anëtarët e komisionit për organizimin e dëgjimeve buxhetore, dhe ato që kanë prioritet më shumë do të inkorporohen në projekt buxhet.

Pasi që nuk kishte më kërkesa nga banorët, takimi ka mbaruar në orën 20:10.

Procesmbajtëse:

Samire Krasniqi:

_____



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosova

Komuna e Kamenicës
Opština Kamenica
Kamenica Municipality



Lista e pjesëmarrjes së qytetarëve për dëgjimin buxhetor në fshatin Ajnoc
Ora: 19:00

Nr.	Emri dhe mbiemri	Numri i telefonit	Email adresa	Gjinia	Përkatësia etnike	Nënshkrimi ¹²
1.	Dobrevic Goran			BAJNORCE		
2.	Zoran Spojakovic			AJNORCE		
3.	Savic Desian			AJNORCE		
4.	Trakovic DRAGAN			AJNORCE		
5.	MADEKOVIC SRDAN			AJNORCE		
6.	DAKIBDE FILIPAN			BALINORCE		
7.	THAL BOSEK			AJNORCE		
8.	CEKARUK/ROVIC MILA			AJNORCE		
9.	BAROVAN ANIĆ			AJNORCE		

¹ SHQ: Me këtë nënshkrim, i jap leje të plotë Komunës për të më fotografuar, dhe për të bërë xhirime të imazhit dhe zërit tim me qëllim të krijimit të përmbajtjes për komunikim, si dhe ta përdorë këtë për çdo media, qoftë elektronike apo të shtypur. SRB: Ovim potpisom dajem punu dozvolu Opština da me fotografise i snima mene i moj glas u svrhu kreiranja komunikacionog sadržaja, kao i da isto koristi za bilo koji medij, bilo da je elektronski ili štampan.

² SHQ: Me këtë nënshkrim, unë jap pëlqimin tim që Komuna të përpujoj të dhënat e mia personale për qëllime të ligjshme, në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale në Kosovë. SRB: Ovim potpisom dajem svoju saglasnost da Opština obrađuje moje lične podatke u zakonske svrhe, u skladu sa Zakonom o zaštiti podataka o ličnosti na Kosovu.

Nr.	Emri dhe mbiemri	Numri i telefonit	Email adresa	Gjinia	Përkatesia etnike	Nënshkrimi ¹²
10.	Murat Shkurtaj			Ajnocaje		M. Shkurtaj
11.	Çedevir Haxho					Çedevir Haxho
12.	Mirret Gjyshi			Ajnocaj		Mirret Gjyshi
13.						
14.						
15.						
16.						
17.						
18.						
19.						
20.						
21.						
22.						
23.						
24.						
25.						

¹ SHQ: Me këtë nënshkrim, i jap leje të plotë Komunës për të më fotografuar, dhe për të bërë xhirime të imazhit dhe zërit tim me qëllim të krijimit të përmbajtjes për komunikim, si dhe ta përdorë këtë për çdo media, qoftë elektronike apo të shtypur. SRB: Ovim potpisom dajem punu dozvolu Opština da me fotografise i snima mene i moj glas u svrhu kreiranja komunikacionog sadržaja, kao i da isto koristi za bilo koji medij, bilo da je elektronski ili štampar.

² SHQ: Me këtë nënshkrim, unë jap pëlqimin tim që Komuna të përdorë të dhënat e mia personale për qëllime të ligjshme, në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale në Kosovë. SRB: Ovim potpisom dajem svoju saglasnost da Opština obrađuje moje lične podatke u zakonske svrhe, u skladu sa Zakonom o zaštiti podataka o ličnosti na Kosovu.